

## SURETU ED DUHA KAPTINA 93

*E zbritur nē Meke, pas sures El Fexhri, ajete: 11*

*Nē këtë sure flitet pér Muhammedin a.s., pér tē mirat që ia dhuroi Zoti nē këtë jetë dhe pér ato nē jetën tjetër derisa tē bëhej i kënaqur. Pasi ia cek gjendjen e tij kur ishte i vogël, jetim, i varfër, i paudhëzuar, Ai ia përkujton begatitë që ia dha, e nē fund e porosit pér tri çështje: tē jetë i butë pér jetimin, ta mëshirojë nevojtarin dhe t'i udhëzojë njerëzit me atë tē mirën që ia dha Zoti.*

*Quhet: «Suretud Duha» – paraditja, pse Zoti betohet nē tē.*

---

## SURETU EL INSHIRAH KAPTINA 94

*E zbritur nē Meke, pas sures Ed Duha, ajete: 8*

*Kjo sure flet pér pozitën e lartë tē Pejgamberit, tē cilën e gëzon te Zoti i madhëruar, pér disa tē mira tē cilat ia dhuroi Ai dhe i jep guxim nē përpjekjet e tij tē mëtejshme, duke e gëzuar me suksese, që do t'i arrijë nē tē ardhmen.*

*Quhet: «Suretul Inshirahi», – kaptina e hapjes, ngase është fjala pér hapjen e gjoksit tē Pejgamberit.*

15. Që aty nuk hyn tjetër, pos atij që  
është më i prishuri.

16. I cili përgjengjeshtroi dhe u zmbrops.

17. Ndërsa ai që është më i devotshëm  
do të jetë larg tij.

18. Ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet,

19. E jo për ta shpërbyler ndokë që i ka  
bërë mirë më parë.

20. Por vetëm për të fituar kënaqësinë  
e Zotit të vet, më të lartit,

21. Për Zotin, ai do të gëzojë atë  
kënaqësi!\*

### SURETU ED DUHA

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëberësit!*

1. Pasha paraditën!

2. Pasha natën kur shtrinë errësirën!

3. Zoti yt as nuk të ka lënë, as nuk të  
ka përbuzur.

4. Dhe se bota e ardhshme është shumë  
më e mirë për ty se e para.

5. E Zoti yt do të jepë ty, e ti do të  
kënaqesh.

6. A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri  
vend (të dha përkrahje).

7. Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të  
udhëzojë.

8. Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi.

9. Pra, mos e përul jetimin!

10. As lypësin mos e përzë!

11. E me të mirat që të dha Zoti yt, trego  
(udhëzo njerëz)!\*\*

### SURETU EL INSHIRAH

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëberësit!*

1. A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënde?

2. Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde,


\* Zoti xh. sh. betohet në natën që sjell errësirën, në ditën kur ajo shkreptin, në Zotin Krijues i të dy gjinive, se veprat e njerëzve janë të llojlojta, të mira e të këqija, të dëmshme e të dobishme, e më pas shpjegon se ai që jep për hir të Zotit, ruhet prej të këqijave që i ka ndaluar Zoti, beson në Xhennetin, është i bindur për atë që e jep se Zoti do t'i kompenzojë, ose ai që dëshmon me "La ille il-le-llah", atij Zoti i ndihmon që ta marrë rrugën e drejtë e të shpëtimit. E ai që nuk jep, nuk adhuron Zotin, nuk beson të vërtetën, atij do t'i prije e keqja e pasuria e tij e grumbulluar nuk do t'i bëjë dobi kur të bjerë në varr i vdekur, ose kur do të bjerë në fund të xhehenimit.

E tërë bota e sotme dhe bota e ardhme i takon vetëm Zotit, e Ai sqaron rrugën e vërtetë dhe shpjegoi se zjarri i xhehenimit është shumë i fortë dhe se në të do të hyje vetëm ai që është i prishur deri në skaj.

E ai që është rruajt nga të këqijat, nuk do t'i afrohet atij zjarri, e i tillë është ai që e dha pasurinë e vet për hir të Zotit e nuk e dha për t'i a kthyer të mirën dikujt, por vetëm që ta fitojë kënaqësinë e Zotit, e atij Zoti do t'i japë derisa ai të jetë i kënaqur.

Ajetet e fundit u shpalënn për sinqueritetin e Ebu Bekrit r.a.

Bilali ishte rob i Ummeje bin Halefit, i cili e mundonte robin e vet pse kishte pranuar fenë =



3. E cila shtypte shpinën tënde.

4. Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde?

5. E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi.

6. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi.

7. E kur ta kryejsh (*obligimin*, atëbotë mundohu me adhurim (*Allahut*).

8. Dhe, vetëm te Zoti yt përqëndro synimin!\*\*\*